



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2020:038859
Datë: 11.06.2024
Numri i dokumentit: 05806862

PAKR.nr.59/2024

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS - Departamenti për të Krime të Rënda, kolegji i përbërë nga gjyqtarët Xhevdet Abazi, kryetar i kolegjit, Hashim Çollaku dhe Zyhdi Haziri, anëtar, me bashkëpunëtoren profesionale Albulena Rexha, procesmbajtëse, në çështjen penale kundër të akuzuarve, B.P. dhe A.Xh., që të dy nga Prishtina, për shkak të nga një vepre penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e pa autorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge, nga neni 267 par.1 e lidhur me nenin 31 të KPK, duke vendosur sipas ankesave të mbrojtëseve së të akuzuarve, B.P., av.Lendita Keqekolla Gashi, dhe A.Xh., av.Elena Dragusha, të ushtruara kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Krime të Rënda, PKR.192/2021, të dt.06.12.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me dt.06.06.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohen si të pabazuara ankesat, e mbrojtëseve së të akuzuarve, B.P., av.Lendita Keqekolla Gashi, dhe A.Xh., av.Elena Dragusha, kurse aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Krime të Rënda, PKR.192/2021, të dt.06.12.2023, vërtetohet.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Krime të Rënda, PKR.192/2021, të dt.06.12.2023, janë shpallur fajtor të akuzuarit, B.P. dhe A.Xh., për shkak të nga një vepre penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e pa autorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge, nga neni 267 par.1 e lidhur me nenin 31 të KPK, dhe u janë shqiptuar dënimet:

-të akuzuarit B.P., për veprën penale të përshkruar sikurse në pikën I të dispozitivit të aktgjykimit, dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 13 (trembëdhjetë) muajve, i cili dënim do të ekzekutohet në afat prej 15 ditëve, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit dhe dënimin me gjobë në shumë prej 200 (dyqind) Euro.

I akuzuari është obliguar që dënimin me gjobë ta paguajë në afat prej 30 (tridhjetë) ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit, në të kundërtën i njëjti do të zëvendësohet në

dënimin me burgim, duke llogaritur për çdo ditë të kaluar në burg nga 20 Euro, në kuptim të nenit 43 të KPK.

Në dënimin e shqiptuar me burg të akuzuarit B.P., i është llogaritur koha e kaluar në masën e arrestit shtëpiak, nga data 11.06.2019 deri më datë 11.07.2020.

-të akuzuarit A.Xh., dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) viti, i cili dënim do të ekzekutohet në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit dhe dënimin me gjobë në shumë prej 500 (pesëqind) Euro.

Dënimin me gjobë është i obliguar ta paguajë në afat prej 30 (tridhjetë) ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit, në të kundërtën i njëjti do të zëvendësohet në dënimin me burgim, duke llogaritur për çdo ditë të kaluar në burg, nga 20 Euro, në kuptim të nenit 43 të KPK.

Është urdhëruar konfiskimi i sendeve, dhe atë: substanca narkotike e llojit marihuan, Tetrahidrokanabinol (THC), në peshën neto e përgjithshme 650 gram nga i akuzuari A.Xh..

Urdhërohet policia e Kosovës që substancën e konfiskuar ta shkatërroj sipas procedurave ligjore në fuqi.

Janë obliguar të akuzuarit, që t'i paguajnë shpenzimet e procedurës gjyqësore sipas llogarisë përfundimtare në arkë të gjykatës, në emër të paushallit gjyqësor të paguajnë shumën secili veç e veç nga 100 €, ndërsa në emër të taksës për kompensimin e viktimave të krimit, secili veç e veç shumën prej nga 50€, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Kundër këtij aktgjykimi, në afatin ligjor, ankesë kanë ushtruar:

- mbrojtësja e të akuzuarit B.P., av.Lendita Keqekolla Gashi, për shkak të vendimit lidhur me sanksionin penal, duke propozuar që ankesa të aprovohet si e bazuar, dhe aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, të ndryshohet, ashtu që të akuzuarit B.P., ti shqiptohet dënimi më i butë me burgim dhe me gjobë, dhe

-mbrojtësja e të akuzuarit A.Xh., av/Elema Dragusha, për shkak të shkeljes së ligjit penal dhe vendimit lidhur me sanksionin penal, duke propozuar që ankesa të aprovohet si e bazuar dhe aktgjykimi i ankimuar të anulohet, ashtu që çështja penale ti kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim e vendosje, ose i njëjti të ndryshohet dhe të akuzuarit, ti shqiptohet një dënim më i butë apo më i përshtatshëm, duke i pas për bazë të gjitha rrethanat lehtësuese të përmendura në ankesë, dhe konsiderojmë se dënimi me burgim të kushtëzuar do të ishte dënimi më adekuat në këtë rast.

Prokuroria e Apelit në Prishtinë, me shkresën PPA/I.nr.74/2024, të datës 02.02.2024, duke u sqaruar përkitazi me ankesat e ushtruara nga ana e mbrojtësve së të akuzuarve, B.P., av.Lendita Keqekolla Gashi, dhe A.Xh., av.Elena Dragusha, aktgjykimit të ankimuar, si dhe shkresave të tjera të lëndës, ka propozuar që ankesat e ushtruara të refuzohen si të pa bazuara, kurse aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti i Krimeve të Rënda, PKR.192/2021, i dt.06.12.2023, të vërtetohet.

Në kuptim të nenit 390 të KPPK, kolegji i kësaj gjykate ka caktuar seancën e kolegjit për dt.06.06.2024, dhe i ka njoftuar në mënyrë të rregullt të gjitha palët nga shkresat e lëndës.

Në seancë të kolegjit kanë prezantuar, i akuzuari B.P., me mbrojtësen e tij, av.Lendita Keqekolla Gashi, i akuzuari A.Xh., me mbrojtësen av.Elena Dragusha, ndërsa nuk ka prezantuar Prokurori i Apelit, përkundër asaj që ka qenë i njoftuar në mënyrë të rregullt e cila vërtetohet nga shkresat e lëndës.

Mbrojtësja e të akuzuarit B.P., av.Lendita Keqekolla Gashi, ka deklaruar se mbetet pranë ankesës së ushtruar, dhe ka propozuar që vendimi për dënimin të ndryshohet dhe të akuzuarit ti shqiptohet dënim më i butë.

I akuzuari B.P., deklaron se e mbështet paraqitjen e av.Lendita Keqekolla Gashi, si dhe ankesën e ushtruar.

Mbrojtësja e të akuzuarit A.Xh., av.Elena Dragusha, ka deklaruar se mbetet pranë ankesës së ushtruar, dhe ka propozuar që vendimi për dënimin të ndryshohet dhe të akuzuarit ti shqiptohet dënim më i butë.

I akuzuari A.Xh., deklaron se e mbështet paraqitjen e av.Elena Dragusha, si dhe ankesën e ushtruar.

Gjykata e Apelit në kuptim të nenin 394 të KPPK, duke vlerësuar pretendimet ankimore nga ankesat e ushtruara, nga ana e mbrojtëses së të akuzuarit B.P., av.Lendita Keqekolla Gashi, dhe mbrojtëses së të akuzuarit A.Xh., av.Elena Dragusha, aktgjykimit të ankimuar, propozimit me shkrim të Prokurorisë së Apelit në Prishtinë, si dhe shkresave tjera të lëndës ka gjetur se:

Ankesat e mbrojtëseve së të akuzuarve, B.P., av.Lendita Keqekolla Gashi, dhe A.Xh., av.Elena Dragusha, nuk janë të bazuara

Meqenëse aktgjykimi i gjykatës së shkalës së parë nuk është ankimuar për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, kolegji i kësaj gjykate e ka shqyrtuar aktgjykimin si dhe shkresat e tjera të lëndës, dhe ka ardhur në përfundim se i njëjti nuk përfshihet me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale, të parapara në kuptim të nenit 384 të KPPK, për të cilat shkelje kolegji i Gjykatës së Apelit, përkujdeset sipas detyrës zyrtare në pajtim të nenit 394 të KPPK, dhe ka ardhur në përfundim se i njëjti nuk përfshihet me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale, të cilat do të kushtëzonin anulimin e tij, për të cilat kjo gjykatë kujdeset kryesisht sipas detyrës zyrtare.

Sipas ankesës së mbrojtëses së të akuzuarat A.Xh., av.Elena Dragusha, aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është ankimuar për shkak të shkeljeve të ligjit penal, duke pretenduar se në këtë çështje penale gjykata e shkallës së parë nuk e ka vlerësuar parimin e fajësisë, si tërësi, ngase i akuzuari e ka pranuar pjesërisht, duke deklaruar se substancën narkotike e ka pasur për posedim, dhe jo për shitje apo shpërndarje, e cila vërtetohet edhe nga provat e tjera nga shkresat e

lëndës. Asnjë dëshmitarë në këtë çështje penale nuk ka vërtetuar se i akuzuari A., ka kryer veprën penale, andaj jemi të bindur se aktgjykim përfshihet me shkelje të ligjit penal.

Kolegji i kësaj gjykate e ka vlerësuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, përkritazi me ankesën e mbrojtëses së të akuzuarit A.Xh., av.Elena Dragusha, lidhur me shkeljet e ligjit penal, si dhe shkresat e tjera të lëndës, dhe ka ardhur në përfundim që në këtë çështje penale, aktgjykimi nuk përfshihet me shkelje të ligjit penal, sepse gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të qartë ka vlerësuar se pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit A.Xh., është bërë në mënyrë vullnetare dhe në përputhje me provat të cilat kanë qenë pjesë përbërëse e aktakuzës, në prezencën edhe të mbrojtëses. Pasi që është bërë pranimi i fajësisë është marrë mendimi edhe nga ana e prokurorit të çështjes dhe rezulton se janë zbatuar të gjitha dispozitat ligjore, sikurse për të akuzuarin e parë, po ashtu edhe për të akuzuarin e dytë, dhe se pranimi i fajësisë është bërë në kuptim të nenit 322 dhe neni 242 të KPPK, duke përmbushur të gjitha kushtet ligjore, dhe me të gjitha provat materiale, sikurse është procesverbali mbi marrjen në pyetje të akuzuarve, raporti i ekspertimit nga Agjencia e Kosovës për Forenzikë, raporti i bastisjes së shtëpisë dhe personave, i dt.19.10.2019, raporti i këqyrjes së vendit të ngjarjes, dy CD, raporti policor, foto dokumentacioni, andaj që të gjitha këto prova materiale janë vlerësuar dhe kanë pasur relacione të afërta me provat personale, andaj edhe shkeljet e ligjit penal në këtë çështje penale, nuk kanë ardhur në shprehje. Nga kjo rezulton se gjykata e shkallës së parë, pasi që ka vërtetuar elementet e ekzistimit të veprës penale, për secilin të akuzuar, ka aplikuar ligjin i cili ka qenë i aplikueshëm në kohën e kryerjes së veprës penale, se nuk ka gjetur ndonjë rrethanë që i përjashtojnë të akuzuarit, nga përgjegjësia penale dhe nga ndjekja penale, për secilin për veprën penale që i vihet në barrë, andaj vihet në përfundim se gjykata e shkallës së parë, ka vepruar në kuadër të kompetencës ligjore dhe i ka zbatuar të gjitha dispozitat ligjore, që nënkupton se aktgjykimin nuk përfshihet me shkeljet e ligjit penal, në kuptim të nenit 385 të KPPK.

Sipas ankesës së mbrojtëses së të akuzuarit B.P., av.Lendita Keqekolla Gashi, aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, është ankimuar për shkak të vendimit lidhur me sanksionin penal, duke pretenduar se dënimi me burgim e me gjobë, janë të ashpra, sepse gjykata e shkallës së parë, në këtë çështje penale përkritazi me të akuzuarin Bujar, nuk ka gjetur rrethanë rënduese, kurse si rrethana lehtësuese ka pasur parasysh pendimin e të akuzuarit, se i njëjti e ka pranuar fajësinë, se ka bashkëpunuar me organet që kanë zhvilluar procedurë, se ka premtuar që në të ardhmen nuk do të përsërisë vepra penale, se është i martuar, se ka qenë i sinqertë kur ka kërkuar falje, andaj në prani të të gjitha këtyre rrethanave, gjykata e shkallës së parë është dashur që të aplikoj institutin e zbutjes së dënimit, e paraparë në dispozitën ligjore nga neni 71 dhe 72 të KPK, përkritazi me zbutjen e dënimeve, si dhe kufijtë e zbutjes së dënimeve, sepse ka pasur hapësirë të mjaftueshme të aplikohet ky lloj instituti, e sidomos se i akuzuari e ka pranuar fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë.

Po ashtu kolegji i kësaj gjykate ka pranuar ankesën e mbrojtëses së të akuzuarit A.Xh., av.Elena Dragusha, lidhur me vendimin për sanksionin penal, duke pretenduar në ankesë mbrojtësja e të akuzuarit, se në këtë çështje penale nuk janë vlerësuar në masë të duhur rrethanat lehtësuese, sikurse janë se i akuzuari A., e ka pranuar fajësinë për veprën penale, për të cilën është akuzuar, se ka shpreh keqardhje, se ka premtuar që në të ardhmen nuk ka me ra në kundërshtim me ligjin, se ka qenë bashkëpunues me organet të cilat kanë zhvilluar procedurë, se është mbajtës i familjes, i martuar, baba i dy fëmijëve, se i njëjti ka qenë i sinqertë dhe korrekt gjatë mbajtjes së

shqyrtimit gjyqësor, andaj në prani të këtyre rrethanave, jemi të bindur se vendimi për dënimin është i ashpër, dhe propozon që të njëjtit ti shqiptohet dënim më i butë, apo më i përshtatshëm, duke pasur parasysh rrethanat lehtësuese.

Kolegji i kësaj gjykate ka vlerësuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë lidhur me vendimin për sanksionin penal, si dhe shkresat e tjera të lëndës, sipas ankesave të ushtruara nga ana e mbrojtëseve së të akuzuarve, B.P., av.Lendita Keqekolla Gashi, dhe A.Xh., av.Elena Dragusha, dhe ka ardhur në përfundim se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë nuk përfshihet me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale, si dhe shkeljet e ligjit penal, se gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë, e cila vërtetohet nga shkresat e lëndës, e sidomos nga pranimi i fajësisë, nga ana e secilit të akuzuar, ashtu që me rastin e marrjes së vendimit për dënimin, caktimit të llojit dhe lartësisë së tij, ka vlerësuar se në mënyrë të drejtë janë aplikuar dispozitat ligjore nga neni 69 lidhur me nenin 70 të KPK, kur janë vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese, se secili i akuzuari e ka pranuar fajësinë për secilën veprë penale e cila i vihet në barrë, se të njëjtit kanë qenë të sinqertë dhe janë penduar për veprën penale të kryer, nga ana e secilit prej tyre, kanë premtuar që në të ardhmen nuk kanë me ra në kundërshtim me ligjin, se kanë qenë bashkëpunues me organet të cilat kanë zhvilluar procedurë, se janë mbajtës të familjeve, ashtu që përpos këtyre rrethanave gjykata e shkallës së parë me rastin e shqiptimit me burgim për secilin të akuzuar, ka vlerësuar dispozitën ligjore nga neni 71 dhe 72 të KPK, lidhur me dispozitën për zbutjen e dënimeve, si dhe kufijtë e zbutjes së dënimeve, dhe të akuzuarve, u ka shqiptuar minimumin e dënimit. Sa u përket rrethanave rënduese në këtë çështje penale sipas aktgjykimit rezulton se nuk ka pasur, mirëpo kolegji i kësaj gjykate duke i vlerësuar ankesat e mbrojtësve së të akuzuarve, nga asnjëra prej tyre nuk ka gjetur ndonjë rrethanë posaçërisht lehtësuese, por duke pasur parasysh mënyrën e kryerjes së veprës penale, si dhe shkallën e intensitetit të kryerjes së të njëjtës, nga secili i akuzuar, ka vlerësuar se me dënimet e shqiptuara secilit të akuzuar, sikurse në dispozitiv të aktgjykimit, do të arrihet efekti dhe qëllimi i tyre, që të parandalojë kryerësit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale, të bëjë kompensimin e viktimave ose të komunitetit për humbjet ose dëmet e shkaktuara nga vepra penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit, të paraparë në nenin 38 të KPK-së.

Nga sa u tha më lartë e në pajtim me dispozitën e nenit 401 të KPPK, u vendos sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
PAKR.nr.59/2024, të datës 06.06.2024

Procesmbajtësja,
Albulena Rexha

Anëtarët e kolegjit,
Hashim Çollaku

Kryetari i kolegjit,
Xhevdet Abazi

Zyhdi Haziri